

KONTRATE PER THEMELIMIN E SHOQERISE
“RIVER CONSTRUCTION” SHPK

Sot, me date 08.05.2024 (dymije e njetete e kater), personi i meposhtem : z.Fatos Jaupi, me vullnet te lire themelon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar :
“RIVER CONSTRUCTION” SHPK, dhe harton per kete qellim AKTIN E THEMELIMIT te shoqerise me permbajtje si vijon:

Baza Ligjore : Ligji 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare” i ndyshuar , Kodi Civil ne R.SH.

NENI 1

Shoqeria private “RIVER CONSTRUCTION” SH.P.K, formohet vetem me nje ortak themelues : z. FATOS JAUPI

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Velabisht, Berat
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, me zgjerimin e aktiviteti si brenda dhe jashte Shqiperise.

NENI 3

Afati i ushtrimit te veprimtarise se shoqerise eshte per nje kohe te pakufizuar e duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar .

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise “River Construction” shpk eshte te ushtroje veprimtari si me poshte:

Sherbime ne fushen e ndertimit si ndertim i objekteve industriale dhe civile, rikonstruksione objekte sociale kulturore, industriale, banesa, eksport – import i makinerive e materileve te ndertimit, prodhimi dhe ndertimi i materiale te ndertimit. Bar, restaurant, tregti me shumice e pakice te artikujve te ndyshme ushqimore, industriale, lende te para si dhe import dhe eksportimi i tyre. Veprimtari ne fushen e turizmit e hotelerise si dhe agjensise per shitje – blerje e dhenie me qira te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Prodhim dhe tregtim i materialeve te ndertimit. Shfrytezimi i minieraleve te grupit te katert sipas ligjit mineral shqiptar si gur, argjil etj.. si dhe kryerjen e punimeve me lende plasese. Transport kombetar e ndekombetar i mallrave dhe udhetareve per vete e te trete. Kryerja e cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve dhe legjislacionit ne fuqi

KAPITALI I SHOQERISE


NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqinde mije leke)

Numri i pjeseve ne kapital eshte 1 pjese.

Vlera Nominale e nje pjese eshte 1.000 leke

Kapitali themltar prej 100.000 (njqinde mije) leke eshte kontribut i vetem i z.Fatos Jaupi



NENI 6

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hyje ne marredhenie me persona juridike dhe fizike, vendas dhe te huaj, brenda dhe jashte vendit.

Shoqeria ka te drejte te punesoje specialiste dhe punetore duke nenshkruar kontrata pune ne pajtim te plote me dispozitat e Kodit te Punes.

NENI 7

Te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te marrin te gjitha masat per rritjen e kapitalit te shoqerise, detyrohen te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informatave, te njohurive te fituara gjate aktivitetit te shoqerise dhe te marrin te gjitha masat e nevojshme, per mosdekonspirimin e tyre.

Ata pergjigjen qofte edhe pjeserisht kur nga kjo shkelje vijne pasoja te demshne ekonomike per shoqerine.

NENI 8

Organet e shoqerise jane :

- Administratori.
- Eksperti Kontabel i autorizuar.
- Mbledhja e Ortakeve

NENI 9

Si rregull mbledhjet e Mbledhja e Ortakeve zhvillohet ne vendin ku eshte selia e shoqerise. Per cdo mbledhje mbahet nje procesverbal .

NENI 10

Administratori i shoqerise eshte z. Fatos Jaupi.

Administratori perfaqeson shoqerine.

Administratori pergjigjet civilisht ndaj shoqerise dhe te treteve.

Administratori ka pergjegjesi gjate administrimit te shoqerise.

NENI 11

Te drejtat dhe detyrat e administratorit caktohen ne statut.

NENI 12

Mbledhja e ortakeve ka te drejte te emerohj, ekspertin kontabel te autorizuar .


NENI 13

Veprimtaria financiare e shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti .

NENI 14

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj.

Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe marim persiper te tretet jashte veprimtarise se shoqerise.



NENI 15

Ne rastet kur njeri nga ortakët kerkon të shesë një pjesë ose të gjitha kuotat, për këto kuota që shiten, të drejten e parblerjes e kanë ortakët .

Ne rast refuzimi i kesaj oferte nga ortakët atëherë këto kuota do t'i shiten të treta me vlerën e ofruar ortakëve .

NENI 16

Te gjitha çfare do të futen në shoqëri , makinerite,garancite ,pronat e paluajtshme, të cilat do t'i jepen kompanisë si një depozitë për kuotat duhet të jenë të lira nga borxhet, hipotekat ,ose nga ndonjë detyrim tjetër

NENI 17

Te ardhurat neto që realizohen pas zbritjes së shpenzimeve, të detyrimeve financiare, të rezervës së domosdoshme dhe fondit që do të perdoret për riinvestime të reja ndahen si fitime në formë dividendesh në raport me kapitalin e ortakëve
Fitimet mund të transferohen jashtë shtetit pa asnjë kufizim.

NENI 18

Te gjithë mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë, në rast se nuk kapërcehen me vullnetin e mirë të ortakëve do të zgjidhen në Gjykatë.

NENI 19

Kontrata në pershtatje me ndryshimin e legjislacionit e me kushtet që determinuan lidhjen e saj, mund të ndryshojë me vendim unanim të ortakëve.
Statuti është pjesë perberëse e kontratës dhe i bashkangjitet asaj.

NENI 20

Në rast se ndonjë nga pikat e aktit ose statutit të shoqërisë, nuk është në përputhje me legjislacionin Shqiptar, në asnjë rast nuk mund të sjellë pavlefshmerinë e të gjithë aktit dhe statutit të shoqërisë, por kjo mos marrëveshje mund të zgjidhet në bazë të legjislacionit shqiptar menjëherë mbas konstatimit të sajë.

NENI 21

Ky akt u përpilua në 4 (kater) kopje, me fuqi të barabartë, nga të cilat 1 (një) Kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar pra QKB.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e tij dhe regjistrimin në QKB

ORTAKU I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“RIVER CONSTRUCTION” SHPK

Fatos JAUPI

